

KONSULTENT NË PROJEKTIN PËR EFIÇENCË TË ENERGJISË DHE ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME NË KOSOVË

EKSPERT PËR EFIÇENCË TË ENERGJISË (KONSULENT ME ORAR TË PLOTË) KEEREP-CS-3.6/2022

1. Historiku:

Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, duke përfshirë politikat për eficiency të energjisë. Gjatë periudhës së vitit 2021, janë ndërmarrë një sërë masash legislative dhe jo legislative për arritjen e objektivave të EE të përcaktuara nga Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiency të Energjisë, i cili tashmë është në fazën e rishikimit.

Ministria e Ekonomisë, përmes mekanizmave që veprojnë në kuadër të saj, si AKEE dhe donatorët, ka mbështetur dhe zbatuar shumë projekte në zbatimin e masave për eficiency të energjisë të financuara në formën e kredive/granteve dhe nga buxheti i Kosovës, duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në përmbushjen e detyrimeve të cilat vendi ynë i ka marrë përsipër.

Agjencia e Kosovës për Eficiency të Energjisë - AKEE është organi qendror i administratës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave për eficiency të energjisë.

Agjencia i udhëzon komunat se si t'i zhvillojnë planet dhe t'i monitorojnë ato pas zbatimit të masave për eficiency të energjisë energjetike, që është një fazë shumë e rëndësishme e tërë procesit.

Struktura organizative e AKEE përbëhet nga katër sektorë:

1. Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv të AKEE-së
2. Sektori i Planifikimit
3. Sektori për Monitorim dhe Raportim
4. Sektori për Promovimin dhe Zhvillimin e Projekteve

Objektivi i detyrës së ekspertit

Objektivi i kësaj detyre është që t'i ofrojë ndihmë dhe mbështetje Ministrisë së Ekonomisë, përkatësisht Agjencisë së Kosovës për Eficiency të Energjisë në lidhje me zbatimin e masave për eficiency të energjisë në ndërtesat publike.

2. Detyrat e planifikuara

- Të këshillojë dhe ofrojë rekomandimet e tij Ministrisë së Ekonomisë, përkatësisht AKEE-së, për politikat e ndryshme për promovimin e masave për eficiency të energjisë për periudhën afatshkurtër;
- Të ndihmojë dhe udhëzojë ekipin gjatë zbatimit të projekteve dhe programeve për eficiency të energjisë në zhvillim e sipër përfshirë investimet për eficiency të energjisë në kuadër të AKEE-s dhe FKEE-së;

- T'i ofrojë mbështetje ekipit për promovimin e efijencës së energjisë përmes skemave të stimulimit financiar në bashkëpunim me të gjitha strukturat që punojnë në kuadër të Ministrisë dhe institucioneve tjera përkatëse;
- Të analizojë dhe vlerësojë rezultatet për zbatimin e Planit për Efijencë të Energjisë në Kosovë;
- Zhvillimi i vizitave në terren për të kontrolluar dhe verifikuar zbatimin e duhur të aktiviteteve të EE-së të mbështetura nga Projekti.

3. Kualifikimet e ekspertit

Arsimimi:

Diplomë e nivelit Baçelor ose Master në Inxhinieri Mekanike / Energjetike, Ekonomi, Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë, Drejtësi ose në një lëmi të ngjashme

Përvoja profesionale:

- Së paku 5 vjet përvojë pune të përgjithshme;
- Minimum 3 vite përvojë profesionale në fusha që lidhen me energjinë;
- Përvoja e punës me institucionet vendore dhe/ose agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit paraqet përparësi;
- Njohja e hollësishme e detyrimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë për sektorin e Efijencës së Energjisë.

Kërkesat tjera:

- Shkathtësi të mira komunikuese dhe sociale; kandidati duhet të tregojë iniciativë, organizim dhe dinamizëm personal, si dhe aftësi për të punuar me ekupe dhe për të iniciuar nisma adekuate të planifikimit dhe komunikimit;
- Shkathtësi kompjuterike (Word, Excel, Power Point)
- Njohuri e rrjedhshme e gjuhës angleze.

4. Raportet

- Dorëzimi i raporteve mujore ku përfshihet kontributi i ofruar çdo muaj gjatë periudhës së detyrës në lidhje me zbatimin e projekteve dhe programeve të efijencës së energjisë në zhvillim e sipër, përfshirë investimet në efijencë të energjisë në kuadër të AKEE-së dhe FKKEE-së.

- Raportet duhet t'i dorëzohen Udhëheqësit të AKEE-së dhe ME-së me një kopje që i dërgohet NJZP-së.

1. Periudha e kryerjes së detyrës

Konsulenti do të angazhohet në detyrë me orar të plotë nga muaji korrik 2022 deri në dhjetor 2022. Ai/ajo do t'i raportojë Udhëheqësit të AKEE-së. Eksperti do të angazhohet me orar të plotë nga muaji korrik 2022 deri në fund të dhjetorit 2022. Kontrata do të vazhdohet në bazë të nevojave.